



DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE

| | |
|------------|-------------------------------------|
| Data: | 05.12.2016 |
| Referencë: | |
| Nga: | Heset Sahiti - Drejtor i DSHP-së |
| Për: | Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti |
| Lënda: | Raporti i muajit Nëntor 2016 |

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave gjatë muajit Tetor 2016, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve.

Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

| Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin Nëntor | | | | |
|--|---------------------|---------------------|----------------------|---------------------|
| Nr. i kërkesave të pranuar | Të zgjidhura | Të refuzuara | Në kompetencë | Në procedurë |
| 26 | 16 | | 2 | 8 |

- Janë dhënë Përgjigje, Vendime, Pëlqime, Njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Barazimi i të hyrave me kompaninë “Algemi” sh.p.k e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet, dhe barazimi me të hyrat nga hapësirat publike.
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” e cila bënë pastrimin e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit – pastrimi veror
- Mbikëqyrja e kompanisë “Eing Com” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve në qytetin e Lipjanit.
- Janë bërë kërkesa për zotim të mjeteve: për pastrimin veror të rrugëve për muajin Tetor
- Vizita në teren për përgatitjen e paramasave dhe parallogaritje sipas kërkesave të drejtorateve dhe palëve.
- Është bërë vendosja e shenjzimit vertikal në rrugën “Avdi Kelmendi” dhe “Gjergj Fishta”.
- Vizita në teren për zhblokim të rrjeteve të kanalizimit: Bregu i Zi, Bujan, në qytetin e Lipjanit në kryqëzim të rrugës Isa Olluri dhe Zylfie Gashi, si dhe është bërë prerja e rrugës Halil Meta për deblokim të rrjetit të kanalizimit.
- Janë dhënë pëlqim për prerje të asfaltit për kalimin e gypave në rrugën “Isa Olluri” dhe “Tahir Sinani”
- Kërkesë Drejtorisë së Prokurimit për inicim të procedurave për: shërbimet e merimangës- tërheqja e veturave dhe mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara.
- Marrja pjesë në hapje dhe në vlerësim të ofertave tenderuese për projektet e infrastrukturës.
- Raporte Drejtorisë së Prokurimit për realizimin e punimeve sipas kontratave.
- Pëlqim për parking në rrugën “Lidhja e Prizrenit” është dhënë Radio Taxi Liberty dhe Kam Kosova shpk për ndalje të përkohshme në Rr. “Skenderbeu”
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.
- Është duke u menaxhuar projekti në rregullimin e hapësirave publike – trotuareve.

- Janë duke u menaxhuar punimet në përmirësimin e hapësirave publike projekt i bashkë financuar me DEMOS.
- Mbikëqyrja e punimeve në rrugën Shalë –Baincë, është bërë asfaltimi pritet pranimit teknik
- Mbikëqyrja e ndërtimit të trotuareve në fsh. Ribar i Vogël, punimet vazhdojnë.
- Mbikëqyrja në ndërtimin e kanalizimit në fshatin Rubovc, punimet vazhdojnë.
- Mbikëqyrja e punimeve, ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Gadime, punimet janë duke vazhduar
- Mbikëqyrja e punimeve mirëmbajtja e rrjeteve ekzistuese të kanalizimit
- Mbikëqyrja e punimeve, pastrimi dhe hapja e lumit Sitnica, është duke vazhduar faza e II
- Mbikëqyrja e punimeve në asfaltimin e rrugicave në Topliqan të Vjetër, është bërë pranimit teknik.
- Mbikëqyrja e punimeve në eliminimin e deponive të egra, punimet janë në përfundim
- Mbikëqyrja e punimeve në asfaltimin e rrugëve të qytetit të Lipjani, punimet janë duke vazhduar, kanë filluar me asfaltim të disa rrugëve, dhe po vazhdon me përgatitjen e rrugëve tjera
- Mbikëqyrja e punimeve në instalimin e ngrohjes qendrore nëpër disa shkolla të Komunës së Lipjanit, punimet janë duke vazhduar.
- Mbikëqyrja e punimeve në rregullimin e rrugicave me kubëza në Janjevë punimet kanë përfunduar, pritet pranimit teknik.
- Mbikëqyrja e pllakos me kubëza në oborrin e Xhamisë në Lipjan dhe rregullimi i infrastrukturës në varrezat e Lipjanit punimet janë në përfundim e sipër
- Mbikëqyrja e punimeve në zonën industriale në Qylagë, punimet janë duke vazhduar sipas paramasës.
- Mbikëqyrja e punimeve në ndërtimin e sheshit “Adem Jashari” punimet janë duke vazhduar
- Mbikëqyrja e punimeve në ndërtimin e lapidarëve të martirëve në Ribar të Madh dhe Kraishtë është bërë pranimit teknik
- Mbikëqyrja e punimeve në asfaltimin e rrugëve në Gadime të Ultë punimet janë duke vazhduar me shtrirjen dhe ngjeshjen e zhavorrit, dhe është bërë asfaltimi i një pjese të rrugës prej urës të shpella në drejtim të lagjes Lekiqi dhe asfaltimi i rrugës që shpie të varrezat
- Mbikëqyrja e punimeve në rregullimin e parkut në fshatin Sllovi
- Mbikëqyrja e punimeve në ndërtimin e fushave të sportit në fshatrat Akllap, Konjuh dhe Medvec.
- Puna me palë dhe punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.
- Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së me urdhër të Drejtorit.

| Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së | | |
|--|---|------------|
| Nr | Lloji i aktivitetit | Nr. |
| 1 | Kërkesa, Vendime, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa të ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera | 12 |
| 2 | Takime me përfaqësuesit e fshatrave | 4 |
| 3 | Përgatitja e paramasave dhe parallogarive | 5 |
| 4 | Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit | 0 |
| 5 | Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | 0 |
| 6 | Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal | 0 |
| 7 | Vizita në terren | 104 |
| 8 | Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme | 3 |
| 9 | Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve | 1 |

